

2021

EDUKIMI FINANCIAR

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
dhe Grupi i Bankës Botërore
me mbështetjen e
Qeverisë së Zvicrës



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Kjo broshurë është një produkt i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave (PSDG) në Praktikën Globale të Financave, Konkurrencës dhe Inovacionit të Grupit të Bankës Botërore.

Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike (SECO) i Zvicrës siguroi fonde për materialin në kontekstin e Programit të Remitancave dhe Pagesave.

www.remittanceprices.worldbank.org



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telefon: +1 202 473-1000

Fotoja e kopertinës nga Spencer Montero

© Grupi i Bankës Botërore, 2021

ÇFARË ËSHTË EDUKIMI FINANCIAR DHE PSE ËSHTË AQ I RËNDËSISHËM?

Edukimi financiar nënkupton **një grup njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe sjelljesh** të nevojshme për marrjen e vendimeve të duhura financiare.¹

Në praktikë, edukimi financiar do të thotë se personi ka njohuri themelore dhe mund të kuptojë termet financiare bazë, karakteristikat e shërbimeve dhe produkteve financiare si dhe të ketë qëndrim dhe sjellje pozitive në menaxhimin e financave personale, kursimeve, investimeve, etj.

Në kontekstin e menaxhimit financiar personal dhe të përgjegjshëm, edukimi financiar bazik është vendimtar. Të ardhurat, shpenzimet, mbajtja e shënimeve të shpenzimeve, marrëveshjet, shpejtësia, çmimi, normat e interesit dhe siguria janë faktorë thelbësorë që duhet të merren parasysh kur përdorni produkte dhe shërbime financiare dhe kur menaxhoni me përgjegjësi financat personale. Ju mund të merrni vendime të mirë-informuara vetëm nëse jeni në gjendje të kuptoni veçoritë e produkteve dhe shërbimeve financiare.


¹OECD INFE e përkufizon edukimin financiar bazë si "Një kombinim i ndërgjegjësimit, njohurive, aftësive, qëndrimit dhe sjelljes, që nevojiten për të marrë vendime të shëndosha financiare dhe si përfundim për të arritur mirëqenien financiare individuale.
<https://www.oecd.org/finance/financial-education/49319977.pdf>



SFIDAT MË TË SHPESHTA FINANCIARE ME TË CILAT PËRBALLEMI ÇDO DITË

Cilado qoftë sfida, edukimi financiar kërkon:

1. Vlerësimin e nevojave;
2. Informacion cilësor;
3. Kuptim të opsioneve;
4. Vendimmarrje të shëndoshë.




SFIDAT MË TË ZAKONSHME FINANCIARE ME TË CILAT PËRBALLEMI ÇDO DITË

Nëse nuk keni njohuri të mjaftueshme financiare:

- Nuk do të mund të hulumtoni opsionet dhe ofertat e përshtatshme të tregut;
- Nuk do arrini të kuptoni shtrirjen e të drejtave dhe detyrimeve tuaja;
- Do të paguani për shërbime dhe produkte financiare më të shtrenjta;
- Do të përzgjidhni kanale informale për të dërguar e për të pranuar para;
- Do të merrni vendime vetëm duke u bazuar në të afërm dhe të njohur;
- Do të keni paragjykimet dhe frikë, e do të evitoni përdorimin e teknologjisë moderne.



TË KESH NJOHURI FINANCIARE BAZË DO TË THOTË:



Fitoni njohuri:

Kërkoni informacion dhe mësoni në mënyra të ndryshme, p.sh; në platformën e edukimit të BQK-së www.edukimifinanciar.org ose përmes faqeve të tjera të besueshme në internet, duke kërkuar informata nga ofruesit e shërbimeve financiare, apo duke ndjekur programe trajnimi për financa, ose prezantime publike.

Krijoni aftësi:

Përmirësoni aftësitë tuaja të menaxhimit duke përdorur mjete të specializuara si aplikacione për telefona mobil, kalkulatorët online, ose thjesht monitoroni financat tuaja personale duke mbajtur shënime për të hyrat dhe shpenzimet tuaja si dhe duke krijuar objektiva afatshkurtëra dhe afatgjata.

Mbani një qëndrim pozitiv:

Bëhuni përdorues proaktiv të shërbimit, eksploroni tregun, bëni pyetje dhe kërkoni përgjigje.

Përshtatni sjelljen tuaj:

Duke mbajtur shënime mbi të hyrat dhe shpenzimet tuaja dhe duke analizuar shprehitë dhe sjelljen tuaj financiare, mund të vlerësoni nëse jeni financiarisht i përgjegjshëm dhe çfarë duhet të ndryshoni.

DOBITË E EDUKIMIT FINANCIAR



PËRDORUESI

- Merr vendime të duhura në linjë me interesin e vet ekonomik;
- Planifikon dhe analizon, duke ulur rrezikun potencial financiar;
- Preferon kanale të rregulluara për transfere parash dhe teknologji moderne;
- Negocion me institucionet financiare.



INSTITUCIONET FINANCIARE

- Të shpejtë në përshtatjen me nevojat e përdoruesve të shërbimeve financiare;
- Veprojnë në mënyrë më transparente dhe me përgjegjësi;
- Negociojnë me përdoruesit në lidhje me produktet dhe shërbimet e tyre;
- Ofrojnë shërbime inovative dhe moderne, të cilat, në parim, janë më pak të kushtueshme sesa shërbimet tradicionale.



SHOQËRIA

- Përfshirje më e madhe financiare, veçanërisht e të rinjve dhe grave;
- Reduktimi i aktiviteteteve të tregut të parregulluar, veçanërisht në kontekstin e dërgesave të parave;
- Stabilitet më i madh financiar i institucioneve financiare, shoqërisë dhe vendit;
- Shkallë më e ulët e papunësisë dhe zbutje e varfërisë.

RËNDËSIA E EDUKIMIT FINANCIAR NË KONTEKSTIN E MENAXHIMIT TË PËRGJEGJSHËM TË FINANCAVE PERSONALE

- Edukohuni dhe mësoni terminologjinë financiare;
- Institucionet financiare kanë oferta të ndryshme;
- Kërkoni dhe krahasoni informatat në lidhje me produktet dhe shërbimet financiare nga burime të shumta;
- Analizoni opsionet dhe kërkoni informacion para se të merrni një vendim;
- Kur përdorni produkte dhe shërbime financiare, klienti në të shumtën e rasteve është negociues, kështu që negocioni;
- Tarifat, plani i pagesës, qëllimi, planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve, kontratat, shpejtësia dhe siguria janë faktorë të rëndësishëm;
- Përshtateni sjelljen tuaj financiare bazuar në analiza dhe mbajtjen e shënimeve;
- Teknologjitë moderne hapin mundësi të reja dhe paraqesin rreziqe të reja;
- Ligjet mbrojnë përdoruesit e shërbimeve.



ÇFARË DUHET TË DINI

Vendet me nivele të larta të edukimit financiar kanë këto karakteristika:

- 1.** Janë financiarisht më të qëndrueshme dhe më të pasura;
- 2.** Kanë inflacion të ulët dhe valuta të qëndrueshme;
- 3.** Kanë tregje financiare më dinamike dhe moderne;
- 4.** Pasiguria dhe shqetësimet financiare janë më pak të pranishme në mesin e individëve.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore
e Republikës së Kosovës**

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



THE WORLD BANK

IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telefon: +1 202 473-1000